# FAKTORËT MOTIVUES QË NXISIN TË RINJTË NË PËRZGJEDHJEN E INFERMIERISË SI PROFESIONIN E TYRE TË ARDHSHËM

**Alma IMAMI**
**Brizida REFATLLARI**
**Miranda ÇELA**
**Denisa BEGO**
**Valbona BEZHANI**
*Fakulteti Shkencave Mjekësore Teknike,*
*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë*

**Mark LELÇAJ**
*Spitali Amerikan, Tiranë*

***Abstrakt***
***Qëllimi:*** *Identifikimi i faktorëve motivues që ndikojnë te të rinjtë për të zgjedhur programin e studimit në Infermieri të Përgjithshme.*
***Metoda:*** *Studim cross-sectional realizuar gjatë muajit nëntor 2025, në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT), Tiranë. Në këtë studim morën pjesë 62 studentë, të vitit të tretë të programit Bachelor, pjesëmarrja e të cilëve ishte vullnetare. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të vetadministruar, i përshtatur për të vlerësuar faktorët socialë, personalë dhe profesionalë që kishin motivuar studentët për të studiuar degën Infermieri e Përgjithshme.*
***Rezultate:*** *Në studimin tonë morën pjesë 91.94 % femra dhe 8.06 % meshkuj. Në grupin e pyetjeve të faktorit të interesit personal evidentohet se 96 % e studentëve dëshirojnë që t'u vijnë në ndihmë njerëzve dhe 95% mendojnë se duan të ndikojnë në mirëqënien e tyre. Ndërsa në grupin e pyetjeve që përbëjnë faktorin e ndikimit të shoqërisë, përqindjen më të lartë e zenë mbështetja prindërore me 94%, si dhe të bërit krenar prindërit me 97%. Faktori perspektiva e punës, shpreh përqindjen më të lartë mundësinë për të punuar jashtë shtetit me 92 %, si dhe nuk do të jem kurrë papunë me 74 %.*
***Konkluzione:*** *Gjetjet e studimit treguan se motivimi kryesor për zgjedhjen e programit të Infermierisë lidhej me faktorë personalë, veçanërisht me dëshirën për të ndihmuar të tjerët dhe me ndjenjën e empatisë. Gjithashtu në faktorët e tjerë, ndikimi social dhe perspektiva e punës, veçojmë suportin familjar, si dhe probabilitetin e lartë për të gjetur punë si brenda dhe jashtë vendit.*

**Fjalë kyç:** *studentë, faktorë, zgjedhje, motivim, profesion, infermieri*

# MOTIVATIONAL FACTORS INFLUENCING YOUNG PEOPLE TO CHOOSE NURSING AS THEIR FUTURE PROFESSION


## Abstract

***Aim:*** *To identify the motivational factors that influence young people to choose the General Nursing study programme.*
***Methods:*** *A cross-sectional study was conducted in November 2025 at the Faculty of Technical Medical Sciences (FTMS), Tirana, Albania. The study included 62 third-year undergraduate students who participated voluntarily. The data were collected through a self-administered questionnaire adapted to assess the personal, social, and professional factors that motivated students to study General Nursing.*
***Results:*** *Of the participants, 91.94% were female and 8.06% were male. Regarding personal interest, 96% of students reported that they wanted to help others, while 95% wanted to have a positive impact on their well-being. Regarding social influence, 94% of students identified parental support as a motivating factor, while 97% wanted to make their parents proud. Regarding employment prospects, 92% of students considered the opportunity to work abroad a motivating factor, while 74% believed that they would not be unemployed if they chose this profession.*
***Conclusions:*** *The findings showed that the main motivation for choosing the General Nursing study programme was related to personal factors, especially the desire to help others and their well-being. Social influence and employment prospects were also important factors, particularly family support and the perceived opportunities to find a job both in Albania and abroad.*



***Keywords:*** *students, factors, choice, motivation, profession, nursing*

## Hyrje

Zgjedhja e profesionit është një ndër vendimet më të rëndësishme që një individ bën gjatë jetës së tij (Felaco et al., 2023). Përzgjedhja ndikohet nga disa faktorë motivues që individi i konsideron si determinatë për të ndier kënaqësinë dhe suksesin në punë. Faktorët të cilët nxisin motivimin përfshijnë ndikime të jashtme si: familja, aspektet ekonomike, sistemin arsimor, këshillimin profesional, presionin social dhe rolin e medias (Okafor & Onokwai, 2021). Startimi në universitet i të rinjve në një farë mënyre përcakton rrugën drejt profesionit, por jo gjithmonë.

Vendimi i marrë përfaqëson një nga zgjedhjet më të rëndësishme dhe delikate në adoleshencë, pasi një zgjedhje efektive ndikon pozitivisht në zhvillimin dhe formimin e vetë konceptit të tyre në jetë (Okafor & Onokwai, 2021). Edhe pse shumë individë raportojnë se kanë bërë zgjedhjen e duhur, një pjesë e tyre ndien se ka bërë zgjedhjen e gabuar duke menduar të ndryshojë drejtim (Pool, 2012). Gjithsesi, zgjedhja normalisht nis më herët, që në nivelin parauniversitar/ shkollën e mesme, ku nxënësit bëjnë zgjedhjet lëndore, të cilat kanë një ndikim thuajse vendimtar për aplikimin në universitet, formimin akademik dhe karrierën profesionale për të ardhmen e tyre (Holt-White et al., 2022).

Si shumë profesione dhe infermieria është një profesion, i cili ka historinë, parimet, specifikat, vështirësitë, sfidat, satisfaksionin, perspektivat. Sot, dega Infermieri e Përgjithshme është një ndër degët më të përzgjedhura nga të rinjtë në vendin tonë. Kjo degë ofrohet nga universitetet publike në disa qytete të vendit, por gjithashtu dhe nga universitetet private. Ajo u siguron të rinjve një profesion, i cili u mundëson atyre treg punësimi jo vetëm brenda, por dhe jashtë vendit. Shumë të rinj që mbarojnë sot studimet në vend dëshirojnë të punojnë jashtë. Sipas OBSH rreth një në tetë infermierë punojnë jashtë vendit ku kanë lindur dhe janë formuar profesionalisht. (World Health Organization, 2021). Varësia për infermierë të huaj, të lindur, apo të formuar profesionalisht jashtë vendit ishte 15 herë më e lartë në vendet me të ardhura të larta, krahasuar me vendet e tjera. (World Health Organization, 2021).

Në fazën e zgjedhjes së modelit të vendimmarrjes për karrierën, të rinjtë marrin vendime bazuar në shpërblime dhe kosto (Pool, 2012).

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e profesionit infermier në sistemin shëndetësor, si dhe rolin e tyre në dhënien e një kujdesi cilësor është thelbësore të kuptohet çfarë i shtyn të rinjtë drejt zgjedhjes së këtij profesioni. Në këtë kontekst objektivat e këtij artikulli synojnë të evidentojnë dhe analizojnë faktorët personalë, socialë dhe profesionalë që lidhen me zgjedhjen e infermierisë si profesion duke na ndihmuar të kuptojmë më mirë si ndikojnë këto faktorë në procesin e zgjedhjes.
Kontributi i këtij studimi qëndron në ofrimin e të dhënave empirike plotësuese për literaturën ekzistuese në Shqipëri, të bazuara në perceptimet e një grupi të caktuar studentësh të infermierisë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Tiranë, lidhur me faktorët që i kanë motivuar këta të rinj në zgjedhjen e profesionit të tyre.

**Materiali dhe metoda**

Ky është një studim transversal (cross - sectional) i realizuar në muajin nëntor të vitit 2025, në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në Tiranë. Në këtë studim morën pjesë 62 studentë, të vitit të tretë Bachelor. Pjesëmarrësit u përzgjodhën duke marrë në konsideratë mundësitë praktike të mbledhjes së të dhënave dhe aksesin edrejtpërdrejtë me këtë grup studimi. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të vetadministruar nga ana e studentëve. Pyetësori ishte ndërtuar me pyetje, të cilat synonin mbledhjen e të dhënave rreth disa faktorëve që kishin motivuar studentët për të studiuar degën Infermieri e Përgjithshme. Pyetësori i përdorur në këtë studim u hartua duke u mbështetur në instrumentin e zhvilluar nga Liaw et al., (2017), prej të cilit u selektua faktori i interesit personal, ndikimi social, si dhe perspektiva e punës. Këto faktorë të përzgjedhur përkojnë me objektivat e studimit dhe synimin për të analizuar fushat kryesore që lidhen me zgjedhjen e infermierisë si profesion.
Pjesëmarrja e studentëve ishte vullnetare. Pjesëmarrësit u informuan për qëllimin e studimit dhe u mor konsenti informativ përpara plotësimit të pyetësorëve. Për të gjithë studentët, të cilët shprehën vullnetarizmin për t'u bërë pjesë e studimit u garantua ruajtja e anonimatit, si dhe drejta për të ndërprerë plotësimin e pyetësorit në çdo moment edhe pse kishin shprehur dëshirën e tyre për të qenë pjesëmarrës. Më pas u bë shpërndarja fizikisht e pyetësorëve tek të

gjithë pjesëmarrësit. Secili pjesëmarrës e plotësoi individualisht pyetësorin brenda 5 - 7 min.

Të dhënat e mbledhura u analizuan duke nxjerrë përfundime mbi arsyet kryesore që i kishin shtyrë studentët në përzgjedhjen e degës së studimit. Për vlerësimin e faktorëve motivues u përdor shkalla likert 1–5, ku 1 – është "Plotësisht Jo", 2– është "Jo", 3 – është "as Po, as Jo, 4 – është "Po" dhe 5 – është "Plotësisht Po". Analiza u krye mbi përgjigjet e plota, ndërsa pyetjet pa përgjigje u trajtuan si të dhëna të munguara dhe nuk u përfshinë në llogaritjen e mesatares, deviacionit standard dhe %.


## Rezultatet

**Tabela nr. 1. Shpërndarja e studentëve sipas gjinisë**

| Gjinia | Nr. | % |
|---|---|---|
| **Meshkuj** | 5 | 8.06 % |
| **Femra** | 57 | 91.94 % |
| **Totali** | 62 | 100.00 % |

Në studimin tonë u përfshinë 62 studentë, shumica dërmuese e të cilëve janë femra, 57 (91.94 %), ndërsa meshkujt janë në minorancë, 5 (8.06 %).

Figura nr.1 Shpërndarja e studentëve sipas vendbanimit



Siç vihet re në grafik numri më i madh i studentëve të përfshirë në këtë studim ishin nga Tirana me 58%, pasur nga Lushnja 8%, Korça 6%, Laçi 5%, ndërsa pjesa tjetër e vendbanimeve të studentëve paraqitet me 2 % dhe 3 %.

**Tabela nr. 2 Rrethanat e zgjedhjes**

| **Pyejta** | **Po** | **Jo** | **Pa përgjigje** |
|---|---|---|---|
| | n (%) | n (%) | n |
| **Rezultatet e notave & Maturës shtetërore** | 43 (80) | 11 (20) | 8 |
| **Zgjedhje e detyruar** | 4 (8) | 48 (92) | 10 |
| **Ishte zgjedhja ime e parë** | 36 (58) | 26 (42) | 0 |

Tabela e mësipërme pasqyron faktorin nr.1, i cili i referohet **rrethanave të zgjedhjes** së degës së studimit. Bazuar në përgjigjet e plota, pa përfshirë ato pa përgjigje rezultoi se 80 % e studentëve referuan se zgjedhja e degës së studimit ka qënë mbështetur në rezultatet e maturës shtetërore, si dhe notat e gjimnazit, përkundrejt 20 % të cilët nuk e referuan si të tillë. Gjithashtu për 8 % të studentëve ka qenë zgjedhje e detyruar, ndërsa për 92 % nuk ka qenë e tillë. Përsa i përket zgjedhjes së infermierisë si alternativë e parë, 58% e pohuan si të tillë, përkundrejt 42 % të cilët nuk e referuan se ishte zgjedhja e tyre të parë.

**Tabela nr. 3 Faktori i interesit personal**

| **Pyetja** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **T** | **Pp** | **M** | **SD** |
| **Dëshiroj t'u vij në ndihmë njerëzve** | 0 (0) | 1 (2) | 1 (2) | 22 (35) | 38 (61) | 62 | 0 | 4.56 | 0.62 |
| **Mund të kontribuoj në shoqëri** | 2 (4) | 1 (2) | 10 (21) | 29 (60) | 6 (13) | 48 | 14 | 3.75 | 0.86 |
| **Dëshiroj të ndërtoj një karrierë** | 1 (2) | 3 (5) | 6 (10) | 27 (43) | 25 (40) | 62 | 0 | 4.16 | 0.91 |
| **Më motivon ndërveprimi me njerëzit** | 1 (2) | 2 (3) | 10 (13) | 21 (34) | 28 (45) | 62 | 0 | 4.18 | 0.93 |
| **Dua të kem ndikim në mirëqenien e njerëzve** | 0 (0) | 0 (0) | 3 (5) | 27 (43) | 32 (52) | 62 | 0 | 4.47 | 0.59 |
| **Totali** | | | | | | | | **4.22** | |

Nga të dhënat e lidhura me **faktorin personal,** i cili ka ndikuar në përzgjedhjen e profesionit rezultoi se 96 % e studentëve dëshirojnë t'u vijnë në ndihmë njerëzve. 73% pohojnë se mund të kontribuojnë në shoqëri, 79% mendojnë se i motivon ndërveprimi me njerëzit, ndërsa 95% duan të ndikojnë në mirëqënien e njerëzve.

**Tabela nr. 4 Ndikimet shoqërore**

| | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pyetja** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **T** | **Pp** | **M** | **SD** |
| **Do të jem shumë i/e respektuar në shoqëri.** | 0 (0) | 2 (3) | 15 (24) | 26 (42) | 19 (31) | 62 | 0 | 4.00 | 0.83 |
| **Ky profesion ka një imazh të mirë në publik.** | 1 (2) | 6 (10) | 15 (24) | 23 (37) | 17 (27) | 62 | 0 | 3.79 | 1.01 |
| **Mediat sociale më kanë frymëzuar në zgjedhjen time.** | 22 (36) | 30 (48) | 6 (10) | 2 (3) | 2 (3) | 62 | 0 | 1.90 | 0.94 |
| **Në këtë karrierë nuk ka stigmë gjinore.** | 7 (11) | 13 (22) | 16 (27) | 17 (28) | 7 (12) | 60 | 2 | 3.07 | 1.21 |
| **Prindërit e mi më mbështesin.** | 1 (1) | 0 (0) | 3 (5) | 8 (13) | 50 (81) | 62 | 0 | 4.71 | 0.71 |
| **Dua t'i bëj prindërit krenarë.** | 2 (3) | 0 (0) | 0 (0) | 7 (11) | 53 (86) | 62 | 0 | 4.76 | 0.76 |
| **Miqtë e mi më inkurajuan në zgjedhjen time** | 17 (28) | 14 (23) | 12 (19) | 17 (27) | 2 (3) | 62 | 0 | 2.56 | 1.25 |
| **Miqtë e mi do të më shohin me admirim** | 8 (13) | 5 (8) | 26 (44) | 14 (23) | 7 (12) | 60 | 2 | 3.12 | 1.15 |
| **Totali** | | | | | | | | **3.49** | |

Në faktorin e ndikimeve shoqërore, i cili motivon të rinjtë në zgjedhjen e profesionit infermieror përqindjen më të madhe në këtë

grupim pyetjesh e kanë të bërit krenar prindërit 97%, si dhe mbështetja prindërore me 94%, duke vijuar me të qënit i respektuar në shoqëri 73 %. Ndërsa motivimi nga mediat sociale zë një vend të vogël prej 6%, pasuar me 35 %, të cilët mendojnë se miqtë do t'i shohin me admirim.

**Tabela nr. 5 Perspektiva e punës**

| | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pyetja** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **n (%)** | **T** | **Pp** | **M** | **SD** |
| **Siguron një punë të qëndrueshme** | 1 (1) | 1 (2) | 8 (13) | 36 (58) | 16 (26) | 62 | 0 | 4.05 | 0.78 |
| **Nuk do të jem kurrë papunë** | 0 (0) | 2 (3) | 14 (23) | 34 (55) | 12 (19) | 62 | 0 | 3.90 | 0.74 |
| **Siguron të ardhura të mira** | 2 (3) | 9 (15) | 28 (45) | 18 (29) | 5 (8) | 62 | 0 | 3.24 | 0.92 |
| **Karriera siguron një standard të mirë jetese** | 2 (3) | 3 (5) | 24 (39) | 22 (35) | 11 (18) | 62 | 0 | 3.60 | 0.95 |
| **Ofron mundësi për të punuar jashtë shtetit** | 0 (0) | 1 (2) | 4 (6) | 21 (34) | 36 (58) | 62 | 0 | 4.48 | 0.70 |
| **Ofron shumë mundësi për avancim në karrierë** | 1 (2) | 10 (16) | 17 (28) | 22 (36) | 11 (18) | 61 | 1 | 3.52 | 1.03 |
| **Ofron mundësi për të arritur kualifikime më të larta** | 1 (1) | 3 (5) | 23 (37) | 24 (39) | 11 (18) | 62 | 0 | 3.66 | 0.89 |
| **Totali** | | | | | | | | **3.78** | |

Sipas të dhënave të lidhura me **perspektivën e punës**, 84 % referojnë se siguron një punë të qëndrueshme, 74 % mendojnë se nuk do të jenë kurrë pa punë, 37 % mendojnë se ky profesion siguron të ardhura të mira, 53 % janë të mendimit se karriera u siguron një standart të mirë jetese, 92 % shohin mundësi të mëdha për të punuar jashtë vendit, 54% mendojnë se do të bëjnë karrierë dhe 57% e studentëve perceptojnë një mundësi për të arritur kualifikime të larta.

***Shënim:** *n = numri i përgjigjeve; Pp = Pa pergjigje; T =Totali; M = mesatarja; SD = Devijimi Standard*





**Figura nr. 2** Mesatarja e faktorëve motivues

Me anë të këtij grafiku shprehen vlerat e mesatareve për secilin faktor që ka ndikuar më shumë në motivimin e studentëve për të studiuar degën Infermieri e Përgjithshme. Siç shihet dhe në grafik faktori personal ka një mesatare më të lartë se dy faktorët e tjerë.

**Diskutimi**

Në studim tonë morën pjesë gjithsej 62 studentë, prej të cilëve 5 meshkuj (8.06%) dhe 57 femra (91.94%). Numri i kufizuar i meshkujve është tregues për një numër më të pakët të djemve që ndjekin degën e infermierisë. Referuar dhe numrit të studentëve të degës Infermieri e Përgjithshme, viti i tretë Bachelor në FSHMT, 92% janë femra dhe 8% meshkuj. Ekziston një mendësi se infermieria është një profesion më tepër femëror, sesa mashkullor. Sipas Mbavai et al. (2023), në studimin e kryer në Departamentin e Infermierisë në Njala University, në Sierra Leone, gjithashtu gjetën se infermieria dominohej nga gjinia femërore me 70.8% dhe meshkuj 29.2%.

Bazuar në rrethanat e zgjedhjes së degës së studimit vihet re se 80 % e studentëve referojnë se zgjedhja e degës së studimit ka qënë mbështetur në rezultatet e maturës shtetërore dhe notave të gjimnazit,

përkundrejt 20 %, të cilët nuk e referojnë si të tillë. Përsa i përket zgjedhjes së detyruar vetëm 8 % e studentëve e pohuan si të tillë. Në një studim të kryer në Turqi u gjet se 12.1% e pjesëmarrësve kishin qenë të detyruar të studionin infermierinë për shkak se pikët e fituara prej tyre ishin të mjaftueshme vetëm për këtë degë (Özkol Kılınç et al., 2020).

Faktori personal në këtë studim shihet të jetë determinat në motivimin e studentëve për zgjedhjen e profesionit, krahasuar me dy faktorët e tjerë. Po ashtu një studim i kryer në Singapor nga Liaw et al. (2016) tregoi se zgjedhja e karrierës ndikohej ndjeshëm nga interesat personale, veçanërisht nga dëshira për të ndihmuar dhe kujdesur për të tjerët. Në përputhje me këtë, studentët e infermierisë e identifikuan kujdesin ndaj të tjerëve si një cilësi që ato besojnë që e kanë dhe që është thelbësore në ushtrimin e këtij profesioni.

Rezultatet tona treguan se ndër pyetjet e përfshira në faktorin personal, dëshira për të ndihmuar të tjerët ishte 96 % duke e bërë atë element dominues në procesin e vendimmarrjes. Ky rezultat është i ngjashëm dhe me studime të tjera të kryera nga Mbavai et al. (2023) dhe Nwodoh & Ugwu, (2024), të cilët raportuan se dëshira për të ndihmuar të tjerët ishte respektivisht, 99% dhe 85.75%.

Lidhur me grupin e pyetjeve të ndikimeve shoqërore, të qenurit i respektuar në shoqëri, në studimin tonë shihet të jetë një ndër elementët nxitës, i cili ka shtyrë studentët drejt zgjedhjes me 73%, përkundrejt studimit të kryer nga Özkol Kılınç et al. (2020), të cilët raportuan një përqindje të vogël 4.3%, nga ku evidentohet si një tregues, e cili nuk ka influencuar në zgjedhje.

Përsa i përket mediave sociale, studimi ynë gjeti një ndikim minimal të tyre në përzgjedhjen e profesionit (6%). Ndërsa në një studim të kryer në Hong Kong u gjet se 29.49 % e pjesëmarrësve patën ndikim nga televizori (Law & Arthur, 2003). Gjithashtu edhe studimi i realizuar në Poloni nga Chmielewski et al. (2025) identifikoi rolin e medias dhe serialeve televizive mjekësore si një faktor motivues në zgjedhjen e profesionit infermieror.

Familja për shumë të rinj është mbështetja më e madhe përgjatë viteve të studimit. Në vlerësimin e kryer nga ne u evidentuan dy pika të rëndësishme, mbështetja prindërore, e cila rezultoi 94%, si dhe të bërit krenar prindërit, 97%. Këto të dhëna mbështeten dhe nga studime të tjera ku studentët gjejnë pozitive përkrahjen dhe

mbështetjen prindërore. Në studimin e kryer nga Anieche et al. (2022), mbështetjen konsistente prindërore e gjetën me një influencë të lartë prej 64.2 %, ndërsa Ait Ali et al. (2024) raportuan se inkurajimi nga prindërit ishte një nga faktorët social më të rëndësishëm në zgjedhjen e infermierisë.
Infermieria për shumë të rinj shihet të jetë një nga profesionet e së ardhmes, nxitur kjo dhe nga siguria e gjetjes së një vendi pune pas diplomimit, qoftë brenda apo jashtë vendit. Këto elementë janë komponentë të faktorit perspektiva e punës. Në studimin tonë u gjet se 74% mendojnë se nuk do të jenë kurrë të papunë. Kjo e dhënë tregon se një pjesë e konsiderueshme e studentëve kanë zgjedhur degën e infermierisë si profesionin e tyre të së ardhmes, duke e parë si favorit mundësinë e gjetjes së një vendi pune, e cila bëhet shtysë kryesore në këtë drejtim. Studime të tjera, gjithashtu e identifikojnë perspektivën e punësimit si një pikë e rëndësishme, e cila ka ndikuar në zgjedhje. Konkretisht në studimet e kryera nga Özkol Kılınç et al. (2020), Nwodoh & Ugwu (2024), ky tregues u raportua respektivisht për secilin studim, 61% dhe 78% duke sugjeruar punësimin si një aspekt thelbësor orientues drejt profesionit infermieror.

**Kufizimet e studimit**

Një nga kufizimet e këtij studimi lidhet me numrin relativisht të vogël të pjesëmarrësve dhe përfshirjen vetëm të studentëve të vitit të tretë të infermierisë, gjë që mund të kufizojë përgjithësimin e rezultateve për studentët e të gjitha viteve të studimit. Gjithashtu, përfshirja e vetëm tre faktorëve nga instrumenti origjinal, mund të kufizojë përgjithësimin e rezultateve dhe mbulimin e plotë të faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit të infermierisë.
Dizanji cross-sectional i përdorur në këtë studim mundëson evidentimin e perceptimeve të studentëve mbi faktorët e analizuar që ndikojnë në zgjedhjen degës së studimit, por nga ana tjetër kufizon përcaktimin e marrëdhënieve shkakësore ndërmjet tyre.

**Konkluzion**

Në studimin tonë evidentohet se të tre faktorët motivues kanë ndikuar tek të rinjtë për të studiuar programin Infermieri e Përgjithshme. Megjithatë, motivimi kryesor lidhet me faktorët personalë,

veçanërisht me dëshirën për të ndihmuar të tjerët dhe me ndjenjën e empatisë.
Gjithashtu, studentët shfaqën një vlerësim të lartë për rolin dhe mbështetjen e prindërve duke e konsideruar suksesin profesional si një mënyrë për të shprehur mirënjohje dhe për t'i bërë ata krenarë. Perspektivat e favorshme të punësimit, brenda dhe jashtë vendit, përbënin një tjetër element të rëndësishëm motivues në zgjedhjen e këtij profesioni.
Nisur nga numri i pakët i studentëve meshkuj në këtë studim, këshillimi për karrierën në shkollat e mesme duhet të orientojë djemtë të shohin mundësinë e ndjekjes së degës Infermieri e Përgjithshme.

**Referenca**


1. Ait Ali, D., Ncila, O., Ouhhamou, S., Rizzo, A., Chirico, F., Khabbache, H. (2024). *Motivations driving career choices: Insights from a study among nursing students. SAGE Open Nursing, 10*, Article 23779608241255876. https://doi.org/10.1177/23779608241255876
2. Anieche, J. E., Standley, I. B., & Obidife, H. I. (2022). *Influencing factors in the choice of nursing as career: A study of students in nursing training institutions in Anambra State, Nigeria*. *International Journal of Medical Science and Health Research, 6*(4), 113–125. https://doi.org/10.51505/ijmshr.2022.6409
3. Chmielewski, A., Przymuszała, P., & Marciniak, R. (2025). *Why do young people choose nursing as their future profession? – A qualitative study on Polish nursing students' motivating factors to apply to nursing and work in the profession after graduation*. *BMC Medical Education*, 25**,** Article 343. https://doi.org/10.1186/s12909-025-06899-0
4. Felaco, C., Zammitti, A., Marcionetti, J., & Parola, A. (2023*). Career choices, representation of work and future planning: A qualitative investigation with Italian university students. Societies, 13*(10), 225. https://doi.org/10.3390/soc13100225
5. Güner, Ş. İ., Karaaslan, S., & Orhun, R. (2019). *Why do nursing and midwifery students choose their profession in Turkey? Eastern Journal of Medicine, 24*(2), 123–129. https://doi.org/10.5505/ejm.2019.74436
6. Holt-White, E., Montacute, R. and Tibbs, L. (2022) *Paving the Way: Careers guidance in secondary schools*. *London: Sutton Trust*.https://doi.org/10.5897/JCMR2022.0335
7. Law, W., & Arthur, D. (2003). What factors influence Hong Kong school students in their choice of a career in nursing? *International Journal of Nursing Studies, 40*(1), 23–32. https://doi.org/10.1016/s0020-7489(02)00029-9

8. Liaw, S. Y., Wu, L. T., Holroyd, E., Wang, W., Lopez, V., Lim, S., & Chow, Y. L. (2016). Why not nursing? Factors influencing healthcare career choice among Singaporean students. *International Nursing Review*, 63(4), 530–538. https://doi.org/10.1111/inr.12312
9. Liaw, S. Y., Wu, L. T., Lopez, V., Chow, Y. L., Lim, S., Holroyd, E., Tan, K. K., & Wang, W. (2017). *Development and psychometric testing of an instrument to compare career choice influences and perceptions of nursing among healthcare students. BMC Medical Education*, 17, Article 72. https://doi.org/10.1186/s12909-017-0910-7
10. Mbavai, J. J., Joseph, M., Bayoh, I., & Bebeley, S. J. (2023). *Factors influencing the increase in the choice of nursing as career among students at the Department of Nursing, Njala University, Bo District, Southern Sierra Leone. Journal of Clinical Medicine and Research, 12*(1), 7–14. https://doi.org/10.5897/JCMR2022.0335
11. Nwodoh, C. O., & Ugwu, C. C. (2024*). Factors that influenced the choice for nursing career among selected Nigerian undergraduate nursing students. African Journal of Biomedical Research*, 27(4s), 1374–1380. https://africanjournalofbiomedicalresearch.com/index.php/AJBR/article/view/1746
12. Okafor, J. C., & Onokwai, M. N. (2021). *Factors influencing the choice of nursing as a career among secondary school students in Oredo and Ovia North-East Local Government Areas of Edo State. Journal of Educational Management, 2*(1), 1–8. https://www.bsum.edu.ng/journals/files/jem/vol2n1/article26.pdf
13. Özkol Kılınç, K., Sarıoğlu Kemer, A., Çaylak Altun, E.,/ & Öztürk, H. (2020). *Factors affecting the choice of profession of 1st grade nursing students. Anadolu Hemşirelik ve Sağlık Bilimleri Dergisi*, *23*(3), 361–368. https://doi.org/10.17049/ataunihem.525852
14. Pool, L. (2012). *How culture influences choosing nursing as a career*. *Whitireia Nursing Journal*, *19*(Issue), 27–42. https://doi.org/10.34074/whit.19
15. World Health Organization. (2021). Global strategic directions for nursing and midwifery 2021–2025. *World Health Organization.* https://www.lazarus.at/wpcontent/uploads/2021/06/WHO_strategic-directions-for-nursing-and-midwifery-2021-2025.pdf